



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË DREJTËSISË PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkohet falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Albulena Haxhiu, Ministre e Ministrisë së Drejtësisë

Adresa: Ndërtesa e ish Rilindjes, Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Drejtësisë (MD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Drejtësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Drejtësisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Sipas Pakos Emergjente Fiskale të aprovuar me vendimin e Qeverisë nr. 01/19 të datës 30.03.2020 parashihej pagesa e shtesës prej 300€ për punëtorët në terren të cilët drejtpërdrejt i ekspozohen rrezikut të infektimit në punë, por jo për gjithë stafin e Institucionit. Lidhur me këtë, ne kemi vërejtur që SHKK kishte paguar 111,900€ për shtesën e Covid-19 për stafin administrativ për muajin prill dhe maj të vitit 2020 jo në përputhje me vendimin e Qeverisë (shih çështjen A1).
- A2 Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) në pagesën e muajit mars të vitit 2020, kishte kompensuar për gatishmëri mjekët dhe hetuesit mjekësor në shumë totale prej 2,647€ bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale, ku kjo e fundit përcakton se shuma e pagesave mund të jetë deri 1,584€ (shih çështjen A2).
- B1 Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, në nëntë pagesa për mallra dhe shërbime në vlerë prej 209,344€, kemi identifikuar se zotimi dhe urdhërblerja ishte bërë pas pranimit të faturës, e që nuk është në pajtim me Rregullën financiare Nr.01/2013 përkatësisht nenin 18 dhe 22 (shih çështjen B1).
- B2 Nga 10 mostrat e testuara kemi vërejtur se 7 fatura në vlerë 38,642€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat ishin mbi 30 ditë (shih çështjen B2).

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretar i Përgjithshëm dhe Zyrtaari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretar i Përgjithshëm dhe Zyrtaari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Drejtësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Drejtësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur dobësi ku nevojiten veprime konkrete në fushën e të hyrave, paga dhe mëditje si dhe mallra dhe shërbime, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1) dhe rekomandimeve. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Pagesa e shtesave të stafit administrativ të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pa mbështetje të duhur ligjore

Gjetja

Qeveria e Kosovës me vendimin Nr.01/19 të datës 30.03.2020, ka aprovuar Pakon Emergjente Fiskale e cila siguron shtesën prej 300€ për punëtorët në terren të cilët i ekspozohen drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punë, po jo i gjithë stafi i Institucionit. Me këtë vendim qeveria kishte autorizuar MF për nxjerrjen e pakos emergjente fiskale ku përcaktoheshin kriteret dhe të gjitha specifikat e nevojshme për zbatimin e vendimit, ku po ashtu ishin dhënë udhëzime se kush mund të ishte përfitues nga kjo pako.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që pjesë e listës së përfituesve të shtesës prej 300€, për muajt prill dhe maj ishte stafi administrativ i ShKK-së, të cilët nuk ishin të përcaktuar si përfitues me vendim. Vlera e paguar për këto shtesa ishte 111,900€.

Sipas ShKK, në listë janë përfshirë të gjithë zyrtarët të cilët kanë punuar, përkundër vendimeve nga ana e Qeverisë që institucionet të punojnë me staf esencial gjatë periudhës së pandemisë.

Ndikimi

Pagesa e shtesave në paga për stafin administrativ të SHKK pa bazën e duhur ligjore ndikon në pagesa të parregullta si dhe dëmtimin e fondeve buxhetore.

Rekomandimi A1

Ministrja e MD duhet të kontrolloj dhe siguroj që të gjitha pagesat për shtesa në paga të punonjësve administrativ të SHKK-së bëhen sipas vendimeve të Qeverisë, Ligjit për ndarjet buxhetore dhe rregulloret tjera financiare për shpenzimin e parasë publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Kompensimi i Gatishmërisë për mjekët në IML

Gjetja

Sipas Ligjit të Punës neni 90, pika 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. Më tutje Kontrata Kolektive Sektoriale (KKS) është dokument bazë dhe unik i cili përcakton mënyrën e përlllogaritjes së kompensimit për gatishmëritë. Tabela 9 e saj e qartëson se si duhet të paguhen gatishmëritë duke mos kaluar vlerën e përcaktuar bazë, 20% të vlerës 660€.

Gjatë auditimit ne kemi vërejtur që, Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML) kishte kompensuar për gatishmëri nëntë (9) mjek dhe tre (3) hetues mjekësor në vlerë 2,647€ apo 220€ për mjek për muajin mars të vitit 2020, ndërsa sipas skemës së KKS në total nuk do duhej të kalonte vlerën prej 1,584€ apo 132€.

Kjo kishte ndodhur pasi IML ka aplikuar pagesën prej 1/3 e pagës bazë për secilin mjek e jo 20% të vlerës 660€.

Ndikimi Kompensimi i gatishmërisë për stafin mjekësor të IML në kundërshtim me KKS rritë rrezikun e pagesave të parregullta dhe në mënyrë jo të ligjshme dëmton buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi A2 Ministrja e MD, përkatësisht Drejtori i përgjithshëm i IML-së duhet të siguroj që pagesat e gatishmërisë të bëhen në përputhje me vlerën e përcaktuar në KKS dhe rregulloret tjera financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja Rregulla financiare Nr.01/2013 përkatësisht neni 18 dhe 22 përcakton që fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhër-blerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Në nëntë pagesa në vlerë prej 209,344€, për mallra dhe shërbime, kemi identifikuar se zotimi dhe urdhërblerja ishte bërë pas pranimit të faturës. Një praktikë e tillë po përsëritet që disa vite edhe përkundër rekomandimit të viteve të kaluara.

Sipas MD, kjo ka ndodhur për shkak se edhe gjatë vitit 2020 janë përballur me vështirësi në zotimin e mjeteve si shkak të pandemisë, ndërsa sipas zyrtarëve të SHKK-së për arsye se Njësitë Kërkuese të saj apo menaxherët e kontratave nëpër Qendrat Korrektuese dhe të Paraburgimit për shkak të natyrës së burgjeve bëjnë furnizim / shërbime bazuar në kontratë, ku zyra e financave pastaj domosdoshmërisht duhet ta bëjë zotimin për ta shlyer obligimin.

Ndikimi Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme mund të rezultojë në vonesa në realizimin e pagesave si dhe rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për periudhat vijuese.

Rekomandimi B1 Ministrja duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregulloret në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara

Gjetja

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 39, paragrafi 1, parasheh që: "Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallrat dhe shërbimet e furnizuara dhe punët e realizuara për organizatën buxhetore, të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagesë nga organizata përkatëse buxhetore.

Nga 10 mostrat e testuara kemi vërejtur se 7 fatura në vlerë 38,642€, nuk ishin paguar brenda afatit të paraparë ligjor. Vonesat ishin mbi 30 ditë.

Kjo çështje po përsëritet nga viti në vit sidomos tek ShKK, për shkak të mungesës së mjeteve dhe vonesave në alokimin e buxhetit.

Ndikimi

Mos kryerja e obligimeve brenda afatit të paraparë ligjor ndikon në rritjen e detyrimeve të papaguara si dhe në rritjen e mundësisë që Ministria t'i ekspozohet padive gjyqësore dhe të paguaj kosto shtesë për mallra dhe shërbime.

Rekomandimi B2

Ministrja duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara do të paguhet brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat përmes procedurave gjyqësore dhe procedurave përmbartimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga MD në 2020 janë 78,244€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat që realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të gjykatave, nga shitja e mallrave, kompensimi I dëmeve nga kopmania e sigurimit dhe qeraja nga objektet publike. Me Ligjin e Buxhetit të vitit 2020 janë buxhetuar për nevoja të MD-së 80,200€ prej të cilave janë shpenzuar 41,598€. Ne kemi testuar shtatë mostra për teste thelbësore në vlerë 10,908€, si dhe pesë mostra për pajtueshmëri ligjore.

Çështja B3 - Mos barazimi i të hyrave

Gjetja Sipas nenit 13 të Rregullës financiare Nr.03/2010-për të hyrat vetanake, thekson se OB pas çdo mbyllje të periudhës mujore është e obliguar që të bëjë barazimin e të hyrave me Thesarin.

Gjatë vitit 2020, zyrtari i të hyrave në Ministrinë e Drejtësisë nuk kishte bërë barazimin mujor për të hyrat në mes të shënimeve të MD-së dhe SHKK-së me Thesarin, siç kërkohet me rregullën financiare. Si rezultat të hyrat e ShKK-së ishin regjistruar te departamenti për profesione të lira në Ministrinë e Drejtësisë.

Arsyeja e mos barazimeve me thesarin ishte koha e pademisë dhe se zyrtarët në Ministri të Drejtësisë dhe Ministri të Financave kanë punuar me staf të reduktuar.

Ndikimi Mos barazimi i të hyrave me Thesarin dhe regjistrimi jo i drejtë i tyre ndikon në paqartësinë e evidencave lidhur me vlerën e grumbulluar të të hyrave mujore të Ministrisë dhe Shërbimit Korrektues.

Rekomandimi B3 Ministrja duhet të sigurohet se barazimi i të hyrave të MD me Thesarin bëhet në baza mujore, në mënyrë që ministria të ketë pasqyrën e plotë dhe të saktë të të hyrave dhe të eliminohen mos përputhjet e gjendjes kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	29,853,811.00	28,281,956.39	21,347,717.68	21,468,816.11	20,051,054.82
Grante Qeveritare – Buxheti	29,773,611.00	28,116,738.28	21,306,119.81	21,265,840.32	19,951,295.59
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	41,597.87	41,597.87	58,784.84	40,424.09
Të hyrat vetanake	80,200.00	80,200.00	0.00	7,002.45	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	0.00	0.00	0.00	137,188.50	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	43,420.24	0.00	0.00	59,335.14

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 1,571,856 €. Ky zvogëlim apo ndryshim i buxhetit është rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore në vlerë prej 1,406,638€, nga të hyrat e bartura 41,598€, të hyrat vetanake 80,200€ si dhe nga vlera e mbetur e donacioneve 43,420€.

Në vitin 2020, MD ka shpenzuar 75% të buxhetit përfundimtar ose 21,347,718€, me një ulje 16% në krahasim me vitin 2019. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	29,853,811.00	28,281,956.39	21,347,717.68	21,468,816.11	20,051,054.82
Pagat dhe mëditjet	13,669,127.00	14,579,467.44	14,498,653.41	13,410,392.41	12,726,640.20
Mallrat dhe shërbimet	6,330,915.00	6,106,964.83	5,360,587.58	5,471,465.05	4,909,373.27
Komunalitë	1,070,769.00	781,911.06	775,129.36	1,113,013.03	1,007,863.31
Subvencionet dhe transferet	6,728,000.00	5,908,314.06	68,456.27	529,597.22	544,950.01
Investimet Kapitale	2,055,000.00	905,299.00	644,891.06	944,348.40	862,228.03

MD kishte lëvizje buxhetore nëpër kategori. Megjithatë, të gjitha lëvizjet/ndryshimet ishin të mbështetura me vendime përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë. Sqarimet rreth ndryshimeve buxhetore janë shpalosur si në vijim:

Buxheti fillestar për paga dhe mëditje ishte 13,669,128€, ndërsa buxheti final 14,579,467€. Në raport me atë fillestar buxheti final ishte rritur për vlerën 910,339€. Në fillim ishte rritur me rishikim të buxhetit 882,315€ pastaj me vendimeve të Qeverisë për menaxhimin e emergjencave nga Covid -19 edhe për vlerën 28,024€;

Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxheti fillestar ishte zvogëluar për vlerën 223,950€. Në fillim bazuar në vendimi Nr.11/26 të datës 21.08.2020 kishte rritje për vlerën 44,400€, si dhe nga donacionet e mbetura të cilat në mungesë të marrëveshjeve barten nga viti në vit për vlerën 43,420€. Pastaj kishte shkurtime buxhetore në vlerë prej 311,770€ nga dy vendimet e Qeverisë. Së pari me vendimin Nr.01/46 të datës 25.11.2020 në vlerë prej 187,101€ si dhe vendimin Nr.09/50 të datës 29.12.2020 në vlerë prej 124,669€;


Buxheti final për shërbime komunale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 288,858€. Në fillim me rishikim të buxhetit kjo kategori kishte shkurtime për 333,451€, ndërsa me vendim të qeverisë nr.09/50 të datës 21.12.2020 kishte rritje për 44,593€.

Buxheti final subvencione dhe transfere në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 819,686€. Fillimisht me rishikim të buxhetit kishte rritje në këtë kategori për 450,000€, ndërsa më vonë me vendimet e qeverisë kishte shkurtime buxhetore në vlerë 1,269,686€. Këto shkurtime ishin me vendimin me Nr.01/46 të datës 25.11.2020 në vlerë prej 214,340€, vendimin Nr.09/50 të datës 21.12.2020 në vlerë prej 7,635€, si dh vendimit nr.07/53 të datës 29.12.2020 për kursime në vlerë prej 1,047,711€.


Buxheti final për investime kapitale në raport me atë fillestar ishte zvogëluar për vlerën 1,149,701€. Ky zvogëlim ishte me rishikim të buxhetit për 746,101€, ndërsa me vendim të qeverisë Nr.01/46 të datës 25.11.2020 për vlerën prej 403,600€.

Vlen të theksohet që MD për menaxhimin e situatës me COVID 19 kishte shpenzuar 977,207€, prej të cilave me vendime të Qeverisë 933,397€, ishin shpenzuar për paga dhe shtesa ndërsa 43,810€ për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Të hyrat e realizuara nga MD në 2020 janë 78,244€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat që realizohen nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive sipas vendimeve të gjykatave, nga shitja e mallrave, kompensimi i dëmeve nga kompania e sigurimit dhe qeraja nga objektet publike.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	65,391.00	54,406.00	78,244.49	267,332.51	189,344.88
Të hyrat jo tatimore	65,391.00	54,406.00	78,244.49	262,939.31	189,344.88
Të hyrat tjera	0.00	0.00	0.00	4,393.20	0.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të MD ka rezultuar në 8 rekomandime kryesore. MD kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Po ashtu, kishte dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, pesë (5) rekomandime janë zbatuar ndërsa për tri (3) nuk kishte filluar zbatimin, siç është paraqitur në Grafikon 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Depozitat	Ministri respektivisht drejtori i ShKK-së duhet të siguroj që zyrtarët përkatës të cilët janë të ngarkuar me menaxhimin e parave të të burgosurve, me rastin e përfundimit të dënimeve, secilit person të liruar nga burgu t'ia kthejnë mjetet që ka në depozitë.	Zyra për menaxhimin e parave të burgosurve kishte bërë kthimin e mjeteve, mirëpo kanë mbetur edhe vetëm një pjesë prej 6,908.73€, ku një pjesë e këtyre mjeteve janë persona që janë shtetas të huaj apo për shkak të ndrrimit të adresave.	I zbatuar
2.	Të hyrat	Ministri duhet të sigurohet se	Edhe këtë vit kemi	Nuk ka filluar zbatimin

		barazimi i të hyrave me Thesarin bëhet në baza mujore, në mënyrë që Thesari të ketë pasqyrën e plotë dhe të saktë të të hyrave të Ministrisë.	vërejtur që nuk është bërë barazimi i të hyrave me Thesarin.	
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministri, respektivisht drejtori i ShKK-së duhet të siguroj se pas përfundimit me sukses të periudhës provuese, punëtorëve do të ju rregullohet kontrata e punës në pajtim me kërkesat ligjore	Nga mostrat e testuara ne SHKK kemi vërejtur se kontratat e nëpunësve ishim azhurnuar pajtim me kërkesat ligjore sipas rekomandimit tone. Tek testet substanciale janë dëshmitë e bashkëngjitura.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri dhe drejtori i ShKK-së duhet të sigurojnë respektimin e kohëzgjatjes së kontratës kornizë, me qëllim që mos të kryhen shërbime mbi bazën e kontratave të skaduara.	Gjatë testimit ne nuk kemi hasur në ndonjë mangësi të kësaj natyre.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhërblerja dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Edhe këtë vit nuk janë respektuar hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi gjatë procedimit të pagesave.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj barkodimin e të gjitha pasurive dhe regjistrimin e të gjitha pasurive nën 1,000€, në sistemin e-pasuria në mënyrë që pasuritë të jenë të plota dhe të prezantohen saktë në RVF.	ShKK ka arritur të identifikoj të gjitha pasuritë dhe të bëjë regjistrimin e tyre ne e-pasuri, si dhe ka larguar pasuritë e vjetra nga regjistri tani vetem kishte mbetur tjetërsimi i tyre, sa i përket pasurive të blera gjatë vitit 2020 ato ishin regjistruar të gjithane regjistrin e-pasuria dhe u ishin vene barkode, mirepo ne mungese te materialit per prodhimin (shtypjen) e barkodeve te gjitha pasurive te blera gjate vitit 2020 zyrtaret e Shkk-se ju kishin vene barkodet e shkruara me dore. Krejt kjo ishte pasi që kompanisë së	I zbatuar

			mehershme i ka përfunduar kontrata ndërsa MAP nuk ka arritur ende të siguroj kontratë tjetër.	
7.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara do të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat përmes procedurave përmbarimore.	Edhe këtë vit MD kishte vonesa në shlyerjen e obligimeve	Nuk ka filluar zbatim
8.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj se rekomandimet e dala nga auditimi i brendshëm përcillen me një proces formal të monitorimit dhe raportimit nga njësitë përgjegjëse dhe të njëjtat rishikohen në mënyrë periodike për të parë progresin e tyre.	Menaxhmenti kishte marrë veprimet e nevojshme për implementimin e rekomandimit.	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për konkluzion	Ministrja e MD duhet të kontrolloj dhe siguroj që të gjitha pagesat për shtesa në paga të punonjësve administrativ të SHKK-së bëhen sipas vendimeve të Qeverisë, Ligjit për ndarjet buxhetore dhe rregulloret tjera financiare për shpenzimin e parasë publike.
2.	Baza për konkluzion	Ministrja e MD, përkatësisht Drejtori i përgjithshëm i IML-së duhet të siguroj që pagesat e gatishmërisë të bëhen në përputhje me vlerën e përcaktuar në KKS dhe rregulloret tjera financiare.
3.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj se respektohen të gjitha procedurat e përcaktuara me rregulloret në mënyrë që para procedimit të pagesave, fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja, të pranohet malli/shërbimi dhe në fund të kryhet pagesa
4.	Baza për konkluzion	Ministrja duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara do të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat përmes procedurave gjyqësore dhe procedurave përmbarimore.
5.	Të hyrat	Ministrja duhet të sigurohet se barazimi i të hyrave të MD me Thesarin bëhet në baza mujore, në mënyrë që ministria të ketë pasqyrën e plotë dhe të saktë të të hyrave dhe të eliminohen mos përputhjet e gjendjes kontabël.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Shkelqim Xhema, Udhëheqës i Auditimit



Arta Kryeziu, Udhëheqëse e ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



Flora Berisha, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.Ne: 02-713

Data/Date: 02/07/2021

Shtojca/Doletë/Annex: 25-

PRISHTINE



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
 NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE/PRANAR/PRIZAR:
 DATED/PROCESSED/POSTAL/EN
 DATE/PROCESSED/ENITTED

Njësia Org. Org. Unit	Shtif. Klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve Sr. Stranica No. Pages
05	47	1067	1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Dt. 02/07/2021

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ardian Bajraktari

Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.⁸ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(ve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Driton Spahiu, 1 053,80 €, nuk e ka marr shtesën sipas KKS Ditor Haliti, 1 114,20 €, shtesa për gatishmeri nuk i paguhet sipas KKS Besim Kameri, 1 152,80 €, shtesa për gatishmeri nuk i paguhet sipas KKS Gani Hyseni, 1 260,06 €, shtesa për gatishmeri nuk i paguhet sipas KKS Driton Krasniqi, 1 136,06 €, shtesa për gatishmeri nuk i paguhet sipas KKS Driton Krasniqi, 1 139,41 €, shtesa për gatishmeri nuk i paguhet sipas KKS
- ⁶ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.